



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



| | | | | |
|---|----------|----------|--------------|---------|
| I | Data | 16.02.24 | Vendi | KAÇANIK |
| | Nj. org. | | Numri | Shtojcë |
| | 01 | | 104/02-10854 | 1. |

Data: 16.02.2024

Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut, në bazë të neni 13 dhe 14.1 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, neni 5, neni 7 dhe neni 9 pika 3 dhe 8 të rregullores MF - nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR DHURIMIN E PASURISË JO FINANCIARE

I. I dhurohet një kompjuter (pc hp 110 s/n CZC4256J46) Shoqatës së Pensionerëve -Kaçanik, në bazë të kërkesës të paraqitur nga kjo shoqatë dhe në bazë të rekomandimit të datës 01.12.2023 të komisionit për vlerësimin e pasurisë jo financiare 01-Nr.104/02-10854/23 i datës 08.05.2023, si dhe duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret e lartshënuara Zyrtari Kryesor Administrativ vendos si vijon:

II. Kompjuteri i përbërë nga : monitori (Dell 24"), shtëpiza (i3-3240), tastiera dhe mausi , i dhurohet Shoqatës së Pensionerëve-Kaçanik.

III. Paisja e dhuruar largohet nga përgjegjësia e komunës, si dhe nga sistemi i e-pasurisë dhe kjo e fundit nuk ka asnjë obligim në mirëmbajtjen e tij.

Arsyetim

Kompjuteri i dhuruar i plotëson nevojat elementare, dhe si i tillë është parë e arsyeshme të i dhurohet Shoqatës së Pensionerëve - Kaçanik.

Sipas kërkesës, është vlerësuar që ky kompjuter ju shërben sadopak të zvogëlojnë vështirësitë që kanë anëtarët e kësaj shoqate në zhvillimin e aktiviteteve .

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Drejtorja e Financave,
2. Drejtorja e Administrates,
3. Parashtruesi i kërkesës,
4. Arkivi.



Kryetari i komunës
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS
01Nr. 101/03-6648 /24
Kaçanik, 15.02.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi civil, z.Fadil Guri, Shef i zyrës për komunitete dhe kthim, caktohet Zyrtar për monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit
2. Zyrtari në fjalë do të shërbej si pikë kontaktuese, për të mbledhur dhe analizuar të dhënat lidhur me lëvizjen e qytetarëve të Komunës, në shtetet e Zonës Schengen.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal, mbëshetur në Planin e Punës për Menaxhimin e Procesit të Liberalizimit të Vizave me BE-në, ka sjellë Vendimin Nr.22/178, të dates 13.12.2023, për themelimin e Mekanizmit për paralajmërimin e hershëm për monitorimin e trendit të migrimit. Me qëllim që të mbledhjes së të dhënave të mjaftueshme sa i përket kësaj çështje nga Komunitat, ka kërkuar që të caktohet një zyrtar për të monitoruar trendin e lëvizjes të migrimit pas hyrjes në fuqi të udhëtimit pa viza.

Andaj, duke pasur parasysh këto që i theksuam më lartë, përgatitjen profesionale të punëtorit dhe përvojën e punës, u konstatua se zyrtari në fjalë krahas kryerjes së detyrave në vendin e tij të punës të caktohet edhe zyrtar për monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen;

-z. Fadil Guri z.

-Udhëheqësi i personelit dhe

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi